

## MENDIM PAKICE

Unë, komisionere Xhensila Pine, relatore e trupit gjykues për subjektin e rivlerësimit Valentin Preçi, votova për shkarkimin nga detyra të këtij subjekti, pasi nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, kusht ky i përcaktuar në nenin 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

Në rezultatet e hetimit administrativ, subjektit iu kalua barra e provës për sa vijon:

*“Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur duket se nuk kanë pasur mundësi financiare nga burime të ligjshme të ardhurash për kryerjen e shpenzimeve, evidentuar si vijon:*

- për vitin 2008, balanca negative në vlerën -1.336.380 lekë;
- për vitin 2011, balanca negative në vlerën -1.384.679 lekë;
- për vitin 2016, balanca negative në vlerën -1.812.203 lekë deri në datën 25.1.2017, balanca negative në vlerën -1.402.870 lekë;
- për vitet e mbyllura 2009, 2010, 2012, 2013 dhe 2015, përkatësisht në vlerat -1.252.914 lekë, 427.492 lekë, -374.109 lekë, -719.299 lekë dhe -372.974 lekë”.

Në përfundim të procesit, disa nga pretendimet e ngritura nga subjekti, pas kalimit të barrës së provës, nuk mund të pranohen e pasqyrohen në analizën financiare referuar arsytimit si vijon:

### **1. Në lidhje me pretendimin e subjektit për përdorimin e kredisë si burim krijimi**

Në rezultatet e hetimit administrativ nga Komisioni u vlerësua se në referencë të fakteve dhe dokumentacionit të kohës, kontratës së huas, shoqëruar me tërheqje *cash* të shumës së huas bankare, e cila duket se mbështet faktin se qëllimi i kësaj huaje nuk ka qenë pagesa për shoqërinë ndërtuese, kohës së deklaruar të fillimit të banimit në këtë apartament nga subjekti (maj 2008) dhe jurisprudencës së Kolegjit, shuma 4.950 euro, e tërhequr *cash* në datën 10.4.2008, me burim kontratën e huas/kredisë konsumatore datë 12.3.2008, të pasqyrohet si shpenzim për blerje mobilie, si ka qenë edhe parashikimi në kontratën e kredisë.

Subjekti në prapësime nuk ka depozituar ndonjë dokumentacion ligjor provues dhe nuk ka arritur të dokumentojë si ndryshimin e objektit të kredisë, ashtu dhe transaksionin e pretenduar *cash* tek shoqëria ndërtuese, duke mos provuar më asnjë mandatpagesë të kryer.

Referuar qëllimit të marrjes së kredisë nga subjekti i rivlerësimit me kontratën e huas së datës 12.3.2008, në vlerën 5.500 euro, për mobilim, dhe faktit që kjo kredi është tërhequr *cash* nga subjekti dhe pagesa e pretenduar prej tij si e kryer *cash* në shoqërinë ndërtuese është bërë në të njëjtën ditë me transferimin në llogari të shoqërisë ndërtuese të shumës 24.500 euro, të përfituar nga kredia hipotekore – pretendimi i subjektit se kjo kredi u përdor për pagimin e çmimit të apartamentit nuk u arrit të provohet me asnjë dokumentacion ligjor, duke mbetur vetëm në nivel deklarativ e, si i tillë, nuk mund të merret në konsideratë në analizën financiare.

### **2. Në lidhje me pretendimin e subjektit për të ardhurat nga punësimi i personit të lidhur**

Në rezultatet e hetimit administrativ nga Komisioni janë vlerësuar të mos përfshihen në analizën paraprake të treguesve financiarë të ardhurat e deklaruara nga punësimi i personit të lidhur (bashkëshortes së subjektit) për periudhën 2007 – 2009 në subjektin tregtar “\*\*\*\*”, pasi nuk u vërtetua përfitimi dhe shlyerja e detyrimeve përkatëse tatimore.

Në lidhje me deklarin e këtyre të ardhurave pranë institucioneve tatimore dhe shlyerjen e detyrimeve përkatëse, dega e Arkivit të Sigurimeve ka informuar se për periudhën janar 2007 – dhjetor 2009 nuk figuron në listëpagesa emri F. P., fakt ky i konfirmuar edhe nga vetë subjekti në prapësimet e dërguara.

Subjekti në prapësime nuk ka depozituar dokumentacion ligjor provues për marrëdhënien e punësimit mes palëve. Gjithashtu, nga të dhënat bankare të administruara nga Komisioni nuk rezultojnë kreditime në llogari të personit të lidhur të subjektit, bashkëshortes, në formë të pagave/shpërblimeve/honorareve apo formë tjetër nga subjekti tregtar “\*\*\*\*”.

Pretendimi i subjektit për mungesë dijenie të tij dhe bashkëshortes të mospagimit të detyrimeve nga subjekti tregtar “\*\*\*\*” vjen në kundërshtim me dokumentacionin bankar, në llogari të personit të lidhur ku nuk evidentohen pagesa për përfitime/të ardhura nga marrëdhënia e punësimit.

Në llogari të personit të lidhur ku nuk evidentohen as pagesa për përfitime/të ardhura nga barrëindja e personit të lidhur në periudhën 2009 – 2010, të cilat varen/përfitohen nga derdhja e kontributeve përkatëse të sigurimeve dhe konfirmojnë dijenitë të subjektit dhe personit të lidhur lidhur me mospagimin e detyrimeve nga subjekti tregtar “\*\*\*\*”.

Në këto kushte, është e pamundur të argumentohet që veprimet e subjektit nëpërmjet padisë civile, gjatë procesit dhe në funksion të hetimit administrativ e çlirojnë atë nga përgjegjësitë dhe kthejnë të ardhurat në të ligjshme për qëllim të këtij procesi.

Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës është përcaktuar se: *“Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri e ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore”*. Dhe, në referencë të vendimmarrjeve të Kolegjit për ligjshmërinë e të ardhurave, konkretisht në vendimet nr. 1/2021, nr. 23/2020, nr. 7/2019 dhe nr. 19/2019, subjekti nuk arriti të provojë si përfitimin e të ardhurave nga personi i lidhur, edhe shlyerjen e detyrimeve tatimore, ndaj ato nuk mund të merren në konsideratë në analizën financiare.

### **3. Në lidhje me pretendimin e subjektit për financimin e shpenzimeve të kredisë**

Në rezultatet e hetimit nga Komisioni u vlerësua se në referencë të fakteve dhe dokumentacionit të kohës, nuk provohet mbulimi/financimi i kësteve të kredisë nga babai i bashkëshortes, duke u konsideruar si shpenzime të vetë subjektit dhe personit të lidhur.

Në prapësime të rezultateve të hetimit, subjekti, në lidhje me pretendimet për mbulimin/financimin e kësteve të kredisë nga babai i bashkëshortes, ka depozituar dy deklarata noteriale të vjehrrit dhe të kunatit, në të cilat deklarohet nga këta të fundit se kanë ndihmuar familjen e subjektit për të paguar këstet e kredisë.

Referuar të dhënave nga Emporiki Bank nuk rezulton që babai i bashkëshortes dhe/ose vëllai i saj të kenë paguar/shlyer/financuar ndonjë prej kësteve të kredisë së pretenduar. Dhe, në referim të deklarinave periodike të subjektit dhe bashkëshortes, nuk rezulton që të jetë deklaruar prej tyre mbulimi i pagesave të kredisë prej babait të bashkëshortes apo vëllait të saj.

Deklarimet e subjektit mbi mbulimin e këtyre pagesave, vetëm gjatë procesit të rivlerësimit i bëjnë jobindëse gjithë pretendimet e tij, të deklaruara me qëllim atribuirimin e pagesave me burime të ardhurash, të cilat nuk janë deklaruar ndër vite.

Përpyekjet e subjektit të rivlerësimit që sjellin në skenë deklarime të kryera gjatë procesit, duke përdorur si burim të ardhura që u përkasin individëve për të cilët nuk ka deklaruar ndër vite, përbëjnë një inkoherencë në zbatimin e ligjit, një përpjekje për të favorizuar mungesën e transparencës për burimet financiare në dispozicion dhe evitimin e kontrollit, të cilit subjektet duhet t'i nënshtrohen për shkak të nenit 179/b të Kushtetutës dhe nenit D të Aneksit të saj.

Në bazë të jurisprudencës së Kolegjit (vendim nr. 11/2019, nr. 34/2019 dhe nr. 2/2020 ), këto deklarime të kryera gjatë procesit nuk mund të merren në konsideratë në analizën financiare.

#### **4. Në lidhje me pretendimin e subjektit për shpenzimet për udhëtimet jashtë vendit**

Në rezultatet e hetimit dhe në analizën paraprake financiare, zëri shpenzime për udhëtimet jashtë vendit (shpenzime transporti dhe qëndrimi) është pasqyruar/llogaritur mbi bazë të dokumentacionit ligjor të disponuar, deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, si dhe referuar metodologjisë së aplikuar nga Kolegji<sup>1</sup>, gjithashtu Komisioni ka vlerësuar të marrë në konsideratë deklarimin e bërë nga subjekti në procesverbalin e ILDKPKI-së në datën 9.3.2016.

Në ILDKPKI, në datën 9.3.2016, subjekti është përgjigjur ndër të tjera se: *“Për qëllime private, me sa mbaj mend, kam qenë një herë në Itali me bashkëshorten, kam qenë në SHBA rreth 10-11 herë, duke u nisur edhe nga fakti që ka jetuar dhe punuar bashkëshortja ime, shpenzimet janë mbuluar nga të ardhurat e mia dhe të bashkëshortes”.*

Për sa i përket të dhënave konfidenciale si seksion i formularëve të deklarimeve periodike vjetore nga subjekti dhe/ose personi i lidhur, prej tyre nuk janë deklaruar dhurime/financime/donacione për shpenzime udhëtimi, qofshin këto në formë monetare, ashtu edhe në blerje biletash, paketash turistike dhe/ose mbulim të shpenzimeve të pretenduara më pas për këto udhëtime, ndaj edhe mbulimet e shpenzimeve të pretenduara dhe të padeklaruara gjatë deklarimeve periodike nuk mund të merren në konsideratë në analizën financiare.

#### **5. Në lidhje me pretendimin e subjektit për të ardhurat e bashkëshortes në SHBA**

Në rezultatet e hetimit dhe analizën paraprake financiare në lidhje me të ardhurat nga paga e bashkëshortes në SHBA, nga Komisioni janë vlerësuar të pasqyrohen në kohë dhe vlerë, mbështetur në dokumentacionin e depozituar nga subjekti.

Në DIPPV-në e vitit 2011, subjekti ka deklaruar të ardhura nga paga e bashkëshortes në Ohio, SHBA dhe si përkthyes në vlerën 5.702 USD. Në prapësime, shuma e pretenduar nga subjekti është 5.958 USD, pra më e lartë se ajo në deklarimin periodik.

Subjektit të rivlerësimit, pas riçeljes së hetimit administrativ, iu kërkuan shpjegime dhe prova lidhur me këto të ardhura dhe ai ka dërguar shpjegimet dhe argumentet, si dhe ka dorëzuar prova mbi kërkesën e bërë nga Komisioni në lidhje me pretendimet e tij për rishikimin e analizës financiare për të ardhurat në SHBA.

Referuar dokumentacionit të depozituar nga subjekti, i cili i përket vitit 2016, në kolonën shuma e përfutur, nuk është përcaktuar si vlerë mujore, duke mos provuar sa subjekti ka pretenduar se vlera duhet të shumëzohet me numrin e muajve të periudhës.

Pra, shuma e pretenduar si përfitim nga bashkëshortja e subjektit në prapësime nuk provohet nga të dhënat e dokumentit të përfitimit të asistencës sociale. Subjekti, në lidhje me vlerat që

---

<sup>1</sup> Vendim nr. 11, datë 22.5.2019.

pretendon se ka përfituar nga asistenca sociale, nuk ka depozituar dokumentacion ligjor provues ligjor për shumën e pretenduar dhe kohën e tërheqjes së tyre.

Shumat e pretenduara vijnë në kundërshtim edhe me vetë deklaratimet vjetore për vitet 2009, 2010, 2012, 2013 dhe 2014, ku vlera e të ardhurave nga asistenca sociale në SHBA, deklaruar nga subjekti dhe/ose personi i lidhur, është konsiderueshëm më e ulët se ajo e pretenduar nga subjekti gjatë hetimit administrativ. Në vitin 2014, referuar deklaratimit periodik, të subjektit të rivlerësimit, të ardhurat e deklaruara si të përfituara nga familja nga ndihma ekonomike në SHBA deklarohen në vlerën 1.300 USD, ndërsa në prapësime nga ana e subjektit për këtë vit pretendohen rreth 6.337 USD.

Sa më sipër, subjekti nuk ka arritur të provojë shumat e pretenduara si të ardhura të përfituara nga asistenca sociale për vitet 2009, 2010, 2012, 2013 dhe 2014, ndaj dhe ato nuk mund të merren në konsideratë dhe nuk mund të përfshihen në analizën financiare.

#### **6. Në lidhje me pretendimin e subjektit për pagimin e shumës 5.000 euro në vitin 2014**

Pretendimet e subjektit gjatë hetimit administrativ për përdorimin e gjendjes *cash* të padekluar, të pakësuar në vitin 2014, si burim krijimi për pagesën e kryer shoqërisë ndërtuese, e konsideroj të pabazuar, pasi është në kundërshtim me deklaratimin e tij të vitit 2014, ku nuk ishte deklaruar nga vetë subjekti pakësimi i gjendjes *cash* për kryerjen e kësaj pagese.

Përdorimi i gjendjes *cash*, i cili nuk është deklaruar si pakësim, është qartësuar dhe konsoliduar nga vendimmarrjet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit ku, ndër të tjera, Komisioni orientohet se: *“Për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme në të ardhmen ...të mos prezumohet përdorimi nga subjektet i gjendjeve cash si burime për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, për sa kohë një gjë e tillë nuk është deklaruar në mënyrë të qartë dhe të plotë nga vetë subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike [...]”*.

Për rrjedhojë, ky pretendim i subjektit për përdorimin e gjendjes *cash* të padekluar, të pakësuar në vitin 2014, si burim krijimi për pagesën e kryer shoqërisë ndërtuese, nuk mund të merret në konsideratë dhe nuk mund të përfshihet në analizën financiare.

#### **7. Në lidhje me gjendjet *cash* të deklaruara**

Për sa i përket pasqyrimin të likuiditeteve *cash* të deklaruara të krijuara nga subjekti dhe personi i lidhur, si dhe gjendjes së tyre në datën 31.12.2012, nga Komisioni në rezultatet e hetimit dhe në analizën financiare është vlerësuar që për vitin 2012 të shtohet shuma e likuiditeteve *cash* në lekë, në shumën 200.000 lekë, ndërsa shuma e likuiditeteve në dollar në SHBA të shtohet me 300 USD, referuar deklaratimit të vetë subjektit në DIPPV-në e vitit 2012, ku deklaroi specifikisht *gjendje likuiditetesh në lekë, të kursyera për vitin 2012, në shumën 200.000 lekë (në pjesë 100%); gjendje cash në shtëpi nga kursimet e familjes në SHBA, shuma 6.000 USD, si dhe ecurinë e gjendjeve cash të deklaruara.*

Në lidhje me mundësinë financiare të subjektit për krijimin e kësaj shtese në këtë vit, në analizën financiare, përveç shumës 5.700 USD (6.000 USD – 300 USD) si pasuri e krijuar, është shtuar si pagesë/shpenzim kthimi i huas ndaj kumatit në shumën 5.000 euro që, në analizë të gjendjeve *cash* të llogaritura sipas rezultateve të hetimit, ky vit do të rezultonte me një balancë negative.

Në rezultatet e hetimit dhe në analizën financiare nga Komisioni, kursimet *cash* në banesë janë pasqyruar referuar deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, personit të lidhur, përcaktimeve në legjislacionin përkatës, jurisprudencës së Kolegjit, duke analizuar dokumentacionin ligjor justifikues të burimit të deklaruar, mundësinë financiare për krijimin dhe destinacionin e tyre.

Në analizë janë përfshirë në ndryshim të likuiditeteve vetëm kursimet *cash*, që kanë rezultuar të jenë krijuar me burime të ligjshme. Pra, në vitet që subjekti ka deklaruar krijimin/shtimin e tyre, të jetë dokumentuar burimi i deklaruar, si dhe mundësia financiare e subjektit dhe/ose personit të lidhur për krijimin/shtesën e pretenduar.

Njohja dhe marrja në konsideratë vetëm e burimeve të deklaruara për të cilat është provuar ligjshmëria e tyre, do të jepte një paraqitje më të drejtë të situatës financiare të subjektit të rivlerësimit për vitet në të cilat subjekti ka deklaruar përdorimin e këtyre likuiditeteve *cash*.

Shpjegimet dhe pretendimet e subjektit lidhur me gjendjet *cash* vijnë në kundërshtim me jurisprudencën e Kolegjit, i cili në vendimin nr. 26, datë 6.7.2022, referon se: “*Vetëm kursimet e mundshme cash duhet të llogariten si burime të ligjshme për financimin e apartamentit në vitin 2016*”, ndaj dhe ato nuk mund të pranohen/përfshihen në analizën financiare.

Në konkluzion të sa më sipër, lidhur me panoramën e rrethanave faktike, për kriterin e pasurisë, vlerësoj se mosmarrja në konsideratë e pretendimeve të subjektit, të arsyetuara në këtë mendim pakice, do ta vendoste atë në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve të periudhës së deklaramit, parashikuar nga neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

Pretendimet e subjektit të rivlerësimit gjatë procesit për të shpjeguar balancat negative, me krijimin e artificeve, me synim justifikimin e burimeve të përdorura prej tij për krijimin e pasurive apo mbulimin e shpenzimeve, tregojnë qasjen e subjektit gjatë procesit të rivlerësimit.

Për rrjedhojë, kam votuar për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Valentin Preçi, për sa balancat negative dhe qasja e subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit nuk justifikonin zbatimin e parimit të proporcionalitetit dhe konfirmimin e tij në detyrë.

**Xhensila PINE**  
**Relatore (kundër)**